



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Rasim Rasimi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit S. P. nga fshati P., Komuna V., për shkak të veprës penale ndotja e artikujve ushqimorë që përdorën nga njerëzit apo kafshët nga neni 271 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Viti, P.nr.264/20, të datës 15.03.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1434/2023, të datës 26.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 29.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit S. P., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan –Dega në Viti, P.nr.264/20, të datës 15.03.2022 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.1434/2023, të datës 26.01.2024.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.264/20, të datës 15.03.2022, i dënuari S. P., është shpall fajtor për shkak të veprës penale ndotja e artikujve ushqimorë që përdorën nga njerëzit apo kafshët nga neni 271 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditëve i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Është obliguar i dënuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) € si dhe për kompensimin e viktimave të krimit shumë nën prej 20 (njëzetë) €. I dëmtuari D. A. për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin PA1.nr.1434/2023, të datës 26.01.2024, e ka aprovuar si pjesërisht si të bazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit dhe e ka ndryshuar aktgjykimin shkallës së parë vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të dënuarit S. P. për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i ka shqiptuar dënim me kusht ashtu që i ka vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë, e i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i dënuari brenda periudhës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen veprë tjetër penale. Ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan është refuzuar si e pabazuar. Në pjesët e tjera aktgjykimi mbetet i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit S. P., avokati Shemsedin Pira, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të KPP-së si dhe për shkak të shkeljeve të dispozitave të kodit penal, me propozimin që kërkesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe kjo çështje penale të kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.170/2024, e datës 23.05.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit S. P., të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit, pasi i shqyrtojë shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1, lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pasi i vlerësojë pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa është e pabazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se, aktgjykimi i kundërshtuar përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të KPP-së, dispozitivi i aktgjyimit është i pakuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten në të njëjtin nuk janë potencuar shkaqet mbi faktet vendimtare dhe shkaqet e theksuara janë plotësisht të paqarta dhe në masë të caktuar kundërrthënës dhe rreth fakteve vendimtare ekziston kontradiktë e dukshme lidhur me atë që potencohet në arsyetimin e aktgjyimit, përmbajtjes së shkresave apo procesverbaleve, deponimeve të dhëna në procedurën dhe vet shkresave të lëndës, arsyetimi i aktgjyimit nuk ngërthen në vete shkaqet mbi faktet vendimtare.

Përkitazi me shkeljet e dispozitave të kodit penal në kërkesë pretendohet se, në rastin konkret është shkelur ligji në dëm të dënuarit, këto shkelje janë të natyrës absolute për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare, më tutje theksohet se nuk janë plotësuar elementet e veprës penale ndotja e artikujve ushqimorë që përdorën nga njerëzit apo kafshët nga neni 271 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, pasi që si element qenësor i kësaj veprë penale është kushdo që me ndonjë materie të dëmshme i ndotë artikujt ushqimorë e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk është vërtetuar se i dënuari ta ketë bërë një gjë të tillë.

Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se si aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ashtu edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë janë përpiluar në formën e parashikuar me ligj, pasi që përmbajnë të gjitha elementet që kërkohen sipas dispozitave përkatëse ligjore, si në pjesën e dispozitivit, ashtu edhe në pjesën e arsytimit.

Duke ju referuar pretendimeve të mbrojtjes, Gjykata Supreme e Kosovës ka ardhur në përfundim se dispozitivi i këtyre aktgjykimeve është i qartë, nuk është në kundërshtim me vetveten dhe është në harmoni me arsyetimin e tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është përshkruar në mënyrë të hollësishme vepra penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari S. P., së bashku me faktet dhe rrethanat që e përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit penal.

Nga kjo pjesë e dispozitivit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se janë paraqitur këto elemente të figurës së veprës penale dhe atë: koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale dhe mënyra e kryerjes së veprës penale si dhe mënyrën se si ka ardhur deri te kryerja e veprës penale nga ana e të dënuarit S. P., janë përshkruar të gjitha veprimet inkriminuese të dënuarit të ndërmarra ditën kritike.

Në këtë mënyrë, rezulton se në dispozitivin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, tek pjesa e përshkrimit të veprimeve inkriminuese janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme të gjitha rrethanat dhe faktet të cilat i përbëjnë të gjitha elementet subjektive dhe objektive të figurës së veprës penale për të cilën është shpall fajtor i dënuari S. P..

Po ashtu, edhe në arsyetimin e këtij aktgjykimi shihet qartë që janë paraqitur arsye të mjaftueshme për të gjitha pikat e aktgjykimit, përshkrimet e dhëna në arsyetim përmbajnë të gjitha arsyet për faktet relevante të cilat janë paraqitur qartë dhe në asnjë mënyrë nuk paraqiten si kundërthënëse, ndërsa pjesa e arsytimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë përfshirë arsyet në lidhje me vlerësimin e pretendimeve ankimore, si dhe shkeljet, për të cilat gjykata në fjalë është kujdesur sipas detyrës zyrtare.

Nga arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë dhe nga shkresat tjera të lëndës rezulton se në këtë rast janë vlerësuar dhe analizuar në mënyrën e duhur të gjitha provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ashtu siç është parashikuar në nenin 360, paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale, dhe janë nxjerrë konkluzionet e caktuara, që kanë të bëjnë si me gjendjen faktike, ashtu edhe aspekte tjera juridike.

Përveç që aktgjykimet nuk janë të përfshira me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, Kjo Gjykatë, vlerëson se me aktgjykimet e lartcekura nuk është shkelur as ligji penal në dëm të dënuarit S. P., pasi që në veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha elementet e figurës së veprës penale ndotja e artikujve ushqimorë që përdorën nga njerëzit apo kafshët nga neni 271 paragrafi 8 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për të cilat i dënuari është shpall fajtor. Veprimi me të cilin kryhet kjo vepër penale është ndotja e artikujve ushqimorë të destinuar për njerëz ose kafshë, deri në atë masë sa të

paraqesin rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe shtazëve. Ndotja e artikujve ushqimor mund të bëhet duke hedhur materie të dëmshme në artikujt ushqimor dhe në këtë mënyrë bëhen të pa përdorshme dhe të rrezikshme për shëndetin e njeriut ose të kafshës. Në rastin konkret në këtë çështje penale drejtë kanë gjetur dy gjykatat e instancës më të ulët se në veprimet e të dënuarit S. P. përmbushen elementet objektive dhe subjektive të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor i dënuari.

Në këtë mënyrë me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të gjitha provave drejt ka vërtetuar faktin se ditën kritike me datën 07.07.2018, rreth orës 17.00 në livadh në fshatin P. K. V., janë hedhur pjesë të bukës me gozha dhe llokuma për helmim të minjëve, nga i dënuari S. P., nga të cilat veprime kanë ngordhur 9 lopë të dëmtuarit D. A., pasi që të njëjtat ditën kritike kishin kullotë në këtë livadh. Gjykata e shkallës së parë drejtë e ka konstatuar se i dënuari S. P. e ka kryer veprën penale duke u bazuar në provat personale dhe materiale të cilat janë administruar gjatë seancës gjyqësore, e kjo është vërtetuar me dëshminë e të dëmtuarit D. A., e cila dëshmi mbështetet në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e veçanërisht dëshmia e tij ishte në përputhje me deklaratat e dëshmitarëve R. P., B. M., S. P., B. I., I. Z., pjesërisht edhe në mbrojtjen e të dënuarit S. P..

Po ashtu, pretendimi i mbrojtjes se në këtë çështje penale është dashtë të bëhet një ekspertizë nga Instituti i Veterinarisë ku do të merreshin mostrat nga kafshët e ngordhura, është pretendim i pabazuar, për faktin se me provat e administruara të lartcekura si më lartë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar se i dënuari e ka kryer veprën penale dhe në rastin konkret për gjykatën në këtë çështje ka qenë irelevante nxjerrja e një prove të tillë, meqenëse me të gjitha provat tjera që ishin relevante dhe të administruara në shqyrtimin gjyqësor është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nga gjykata e shkallës së parë se i dënuari e ka kryer veprën penale e cila i vihej në barrë sipas aktit akuzues.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës pretendimet e mbrojtësit të dënuarit për shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarit janë të pabazuara. Kjo Gjykatë, vlerëson se me aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta nuk është shkelur as ligji penal në dëm të të dënuarit S. P., sepse nuk është vërejtur se ekziston ndonjë rrethanë që do ta përjashtonte përgjegjësinë penale apo ndjekjen penale të të dënuarit. Të dy gjykatat drejtë kanë vlerësuar se në veprimet e të dënuarit konsumohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe se në rastin konkret është aplikuar drejtë ligji penal dhe se në mënyrë të drejtë janë aplikuar dispozitat ligjore për caktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit për të dënuarin.

Andaj, nga arsyet e cekura më lart dhe në bazë të nenit 437 të KPP-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.299/2024, më datë 29.05.2024

Procesmbajtës,

Kryetar i kolegjit,

